

## Njoftim për kërkim kandidaturash për ndjekje kualifikimesh

1	Titulli i kursit	Kursi i komandës dhe shtabit të përgjithshëm/ <i>Command and General Staff Course (CGSC)</i>
2	Kriteret e kërkuara të gradës	Major
3	Kriteret e kërkuara të gjuhës	Anglisht minimalisht 80 pikë ALCPT/ECL
4	Përshkrimi	Kursi promovon njohjen dhe bashkëpunimin e institucioneve në rang kombëtar dhe ndërkombëtar në mbrojtjen dhe sigurinë e vendit dhe në luftën kundër terrorizmit. Kursi synon dhënien e njohurive dhe zhvillimin e aftësive të studentëve për të hartuar plane në kuadrin e sfidave me të cilat përballet mbrojtja dhe siguria e vendit dhe me gjere. Kurrikula e kursit përfshin module për njohjen e mjedisit strategjik ndërkombëtar, aplikimi i gjyqimit dhe vlerësimit kritik, zhvillimin dhe vlerësim të lidhshëm, roli i medias dhe kulturës në mjedisin operacional aktual, impakti i kërcënimeve, sfidave, dhe i mundësive në mjedisin e sigurisë ndërkombëtare, zhvillimin e kurseve të veprimit strategjik duke integruar instrumentet e fuqisë kombëtare, politikën dhe strategjitë kombëtare me objektivat ushtarake deri në nivelin taktik të luftës. Me përfundimin e këtij kursi studentët do të jenë më të informuar dhe përgatitur. Përsa i përket njohjes dhe përgatitjes së masave kundër kërcënimeve dhe rreziqeve ndaj mbrojtjes dhe sigurisë së vendit, rajonit dhe me gjere.
5	Kritere plotësuese	E aplikueshme vetëm për personelin femër.
6	Periudha e zhvillimit të kursit	<b>29.03.2022 deri më 09.06.2023</b>
7	Vendi i zhvillimit të kursit	Fort Leavenworth, KS, SHBA.
8	Afati aplikimit elektronik (sipas lidhjes 4)	08.10.2021
9	Kuota	<b>1 (një) kuotë</b>

### **\*Procedurat e Aplikimit:**

- Plotësohet Lidhja 4 duke shkarkuar formatin në "4. Formati i aplikimit individual për kualifikime institucionale ose funksionale brenda dhe jashtë vendit" (<https://www.mod.gov.al/index.php/kurse-dhe-trajtime>)
- Dergohet Email në: [aplikim.qpr@aaf.mil.al](mailto:aplikim.qpr@aaf.mil.al)

Vendos në "CC": [aplikim.shp@aaf.mil.al](mailto:aplikim.shp@aaf.mil.al), [aplikim.mm@aaf.mil.al](mailto:aplikim.mm@aaf.mil.al) si dhe për dijeni aplikanti në email të njoftojë strukturën eprore të drejtpërdrejtë (degët dhe seksionet e personelit G1/A-1/N-1/S-1 dhe drejtorët e drejtorive sipas vartësisë).

\*Shënim: Lexoni Kapitullin III të "Rregullore për aplikimin dhe përzgjedhjen e personelit të FARSH për arsimim dhe trajnim brenda dhe jashtë vendit, miratuar me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 2175, Datë 23.11.2017"

([https://www.mod.gov.al/images/njoftime2017/kursetrajtime/rregullore\\_arsimim\\_brenda\\_%20jashte\\_miratuar.pdf](https://www.mod.gov.al/images/njoftime2017/kursetrajtime/rregullore_arsimim_brenda_%20jashte_miratuar.pdf))